

V E N D I M
Nr.80, datë 18.2.1999

PËR SHPALLJEN “PARK KOMBËTAR “ TË PRESPËS DHE “PEISAZHI I
MBROJTUR TOKËSOR / UJOR TË POGRADECIT

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 12, ligjit nr.7623, datë 13.10.1992, “Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor” dhe të nenit 10, të ligjit 7875, datë 23.11.1994 “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Territori natyror i zonës së Prespës së Madhe dhe i Prespës së Vogël, me sipërfaqe të përgjithshme 27 750 ha, shpallet “PARK KOMBËTAR”, kategoria II menaxhuese (IUCN).

Sipërfaqja e “Parkut Kombëtar” të Prespës përbëhet:

Tokë bujqësore (arë, vreshta, pemëtoje etj)	2100 ha
Tokë pyjore e me bimësi pyjore	13500 ha
Tokë kullosore e livadhe	1828 ha
Sipërfaqe ujore	4950 ha
Sipërfaqe joproduktive, troje, etj	5372 ha

b.”Parku Kombëtar “ i Prespës kufizohet

- në veri kufiri shtetëror (FYROM)
- në lindje kufiri shtetëror (FYROM-Greqi)
- në jug kufiri shtetëror me Greqinë, kurrizi ujëndarës deri te Gryka e Ujkut, Maja e Golinës (1456m), Mali Ivan (1768m), Qafa e Zvezdës (1099 m)
- në perëndim Qafa e Zvezdës (1099m), kuota 1912 (vija ndarëse me pjesën lindore të “Peisazhit të mbrojtur tokësor/ujor” të Pogradecit Maja e Zonjës (2 085), Maja e Pusit (2288m) deri në kufirin shtetëror (FYROM)

2. Territori natyror i pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit, me sipërfaqe të përgjithshme 27 323 ha, shpallet “Peisazh i mbrojtur tokësor/ujor” i Pogradecit, kategoria V menaxhuese (IUCN)

a. Sipërfaqja e “Peisazhit të mbrojtur tokësor/ujor” të Pogradecit përbëhet:

-Tokë bujqësore (arë, vreshta-pemëtoje etj)	2 500 ha
- Tokë pyjore e me bimësi pyjore	10 248 ha
- Tokë kullosore e livadhe	1 367 ha
- Sipërfaqe ujore	11 140 ha
- Sipërfaqe joproduktive troje, etj	672 ha
- Sipërfaqe ekonomike (ndër-indust.)	1 396 ha

b. Territori i “Peisazhit të mbrojtur tokësor/ujor” të Pogradecit kufizohet:

- në veri Qafë Thanë – kufiri shtetëror (FYROM)
- në lindje Kufiri shtetëror (FYROM) dhe vija ndarëse e “Parkut Kombëtar” të Prespës (Maja e Pusit, 2 288m, Maja e Zonjës, 2 085m) dhe kuota 1 912 m.
- në jug Kuota 1 912m, kuota 1 461m dhe kuota 1 589 m.
- në perëndim Kuotat 1 461m dhe 1 589 m, Maja e Beshenikut (1 411m), Maja e Shullerit (1 226 m), Maja e Fushës së Madhe (1 430m), Maja e Muratit (1 520), Qafa e Kotodeshit, Qafa e Thanës.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave (DPPK) të paraqesin, për miratim në KRTRSH, studimin “ Ruajtja e biodiversitetit në rajonin e Ohrit dhe të Prespës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko